# Shenimet Shpjeguese

## 1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqeria ka filluar aktivitetin me 07.01.1997 me objekt :

Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij.Mirembajtja e sistemit , sistemeve te furnizimit me uje te pijshem , prodhimi dhe ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve, sherbimi i grumbullimit, largimit te ujrave te ndotura, mirembajtja e sistemeve te ujrave te ndotura impianteve te pastrimit te tyre.

Sistemi i administrimit te shoqerise eshte me nje nivel.
Aksioner i shoqerise eshte 100% Bashkia Kruje.
Administratori i shoqerise nga 25.05.2019 deri me date 25.05.2022 eshte Z. Ledio Cela.
Keshilli i administrimit te shoqerise ka 3 anetare: Z. Ledio Cela, Z. Athanas Karaja dhe Z. Artur Cela nga data 25.05.2019. deri me 25.05.2022.
Kapitali i shoqerise eshte 193,703,532 leke.
Nr i aksioneve 1.
Selia ndodhet ne Kruje me adrese: Lagja 1, Barabit, Ndertese private 2 kateshe.

Liçensa e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me vendim Nr 18 dat 05 MAJ 2017, pas një proçesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbushjes së të gjitha kërkesave për këtë liçenc nga Enti Rregullator i Ujit ne baze te Ligj Nr. 8102 date 28.03.1996 I ndryshuar si dhe te gjitha aktet ligjor dhe nenligjore ne fuqi "Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit dhe perpunimit t ujrave te ndotura".

*Informacion mbi produktet kryesore dhe sherbimet e UKK*

Bazuar ne vendimin Nr. 18 te KKRR ne date 05.05.2017. te Entit Rregullator te Sektorit te Furnizimit me Uje, eshte e vlefshme deri me dt. 05.05.2021 Objekti i Licenses sipas Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1996 i ndryshiar „Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Per miratimin e kategorive te liçencimit dhe te procedurave per aplikim per liçence" eshte kryeje veprimtarine
perkatese te kualifikuar ne kategorite:

- Kategoria A, Per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik
- Kategoria B,Per largimin e ujrave te ndotura

Ne zona e sherbimit te ketej operatori :
Bashkia: Kruje
Komuna: :

Persa bazuar ne license UKK ofron sherbimet e meposhtme:

i) furnizimin e ujit te pijshem
ii) installimin e matesve

iii) instalimin e pikelidhjeve e rrjetin
iv) azhornimin e rrjetit
v) largim e ujrave te ndotura
vi) trajtim i ujrave te ndotura
vii) shitjen e ujit me bote
viii) etj

Sherbimet e sherbimeve cmimet e te cilave jane te rregulluara jane:

i) furnizim e ujit te pijshem
ii) largim e ujrave te ndotura
iii) trajtim i ujrave te ndotura

Per sherbimet e tjera Shoqeria aplikon çmime te cilat perllogariten mbi bazen e kostos plus marzhi dhe qe aprovohen nga Keshilli Mbikqyres me propozim te Drejtorise.

Pasqyrat Financiare te shoqerise "UJESJELLES KANALIZIME KRUJE " SHA jane pergatitur duke ndjekur e zbatuar Politikat Kryesore Kontabel percaktuar ne Ligjin "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH (2008) dhe udhezimet e Ministrise se Financave.

Politika per njohjen e te drejtave dhe detyrimeve te shoqerise

- Per njohjen e aktiveve
- Per njohjen e te ardhurave e shpenzimeve si dhe
- Per vleresimin e tyre mbeshtetur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, Gjithashtu gjate pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane mbajtur parasysh edhe keto parime:
- Parimi I te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara,
- Parimi I njesise ekonomike
- Parimi I vijueshmerise si dhe
- Parimi I kompesimit.

Karakteristikat cilesore te Pasqyrave Financiare te pergatitura nga "UJESJELLES KANALIZIME KRUJE " SHA jane ato qe e bejne informacionin e ketyre pasqyrave financiare te dobishem dhe te kuptueshem per perdoruesit karakteristikat kryesore qe jane mbajtur parasysh gjate hartimit te tyre jane:

- Materialiteti
- Kuptueshmeria
- Rendesia
- Besaueshmeria
- Parimi I paraqitjes me besnikeri

- Parimi I perparesise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Paanshmeria
- Parimi I maturase
- Parimi I plotesise
- Parimi I qendrueshmerise
- Parimi I krahasueshmerise, ky I fundit ka siguruar zbatimin korrekt dhe te qarte te sandarteve, per paraqitjen e nje informacioni krahasues ne pasqyrat financiare te ketij vitit me vitet e kaluara.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

### Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elementetë metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara.

Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Pasqyrat jane pergatitur duke zbatuar :Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

***Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:***

### Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

### Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 jane 1 euro=123.7 leke.

### Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2020 eshte 15 %.

**Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Aktivet Afatgjata Materiale**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen ne modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e vleren se mbetur. Normat e perdorura jane ne Mjete transporti dhe pajisje informatike 25 % te vleres se mbetur dhe per aktivet e tjera( mobilje dhe vegla pune) 20% te vleres se mbetur. Shoqeria nuk ka Aktive afatgjata materiale.

- Troka, Terrene , Troje dhe Permiresime Rrjete Ujesjelles ( ne varesi te tubazionit) Rrjete Kanalizime 5%
- Depo, Depozita dhe te ngjashme Ndertesat dhe permiresimet 5%
- Makineri e pajisje 20%
- Mjete Transporti 20%
- Pajisje kompjuterike dhe te ngjashme 25%
- Inventar Ekonomik 25%

**Renia ne vlere**

Vlera e mbartur e ndertesave, makineriveve dhe pajisjeve kryesore te Ujesjelles dhe Kanalizime jane testuar cdo vit per renien ne vlere te mundeshme, atehere kur ngjarjet apo kushtet e gjendjes financiare e tyre tregojne qe shuma e mbartur e ketyre aktive nuk mund te rikuperohet.

Ne Rast se per Aktivet identifikohen qe mbartin nje renie ne vleres se tyre atehere shuma e mbartur ne kontabilitet zvogelohet deri ne shumen e rekuperueshme. Shuma e rekuperueshem perfaqesohet nga shuma me e madhe midis vleres se drejte minus kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim, ku kjo e fundit eshte llogaritur si vlera e skontuar e flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te rregulluara nga faktoret e

skut qe mbartin.

Per kete arsye grupohen sipas aftesise se tyre per te gjeneruar flukse hyrese te parase bazuar ne faktin qe keto aktive jane te identifikueshem vecmas dhe qe gjenerojne flukse te rendesishem mjetesh monetare. Aktivet e klasifikuara si te mbajtura per shitje jane njohur me vleren me te voglen ndermjet vleres se mbartur dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Nuk ngarkohet asnje tjeter provizion per zhvlersimin per aktive te tille.

Vleresimet e flukseve te ardhshem te parase te perdorur ne vleresimin e renies ne vlere te aktiveve te lidhura me prodhimin dhe shpendarjen e produkteve te ujesjelles kanalizimeve kryhet duke perdorur vlersimin e riskut ne lidhje me prodhimin dhe performancen e tye .

Zbritja ne Vlere e aktiveve, pervec emrit te mire, aplikohet sa here qe ngjarjet qe kane cuar ne kete renie te vlereses ndryshojne. Shtimet apo pakesimet e renies ne vlere raportohen se bashku me zhvlersimin, harxhimin, dhe amortizimin.

**Gjendjet e inventareve**

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

**Perfitimet e punonjesve**

*A Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat bëjnë të mundur përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është pëgjegjëse për të përcaktuar vlerën minimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore për qëllime të pensionit duke u bazuar në një skemë të pensioneve me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë në skemën e përfimit të pensionit regjistrohen si shpenzime kur ato përllogariten.

**Instrumentat financiar dhe c'rregjistrimi i tyre**

Kompania përdor instrumenta financiare për të manaxhuar dhe zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe kurseve të këmbimit të monedhave.

**Aktivet financiare**

Kompania i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme, ndërsa Investimet klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

*Hua dhe Paradhënie*

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që Kompania planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si te mbajtura per tregtim, dhe ato që Kompania që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që Kompania i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që mbajtësit nuk mund të rikuperojë tërësisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të creditit.

Huatë dhe Paradhënie njihen kur Kompania u bë pjesë e një marrëveshjeje kontraktuale. Huatë dhe Paradhëniet fillimisht maten me kostot duke përfshirë çdo transaksion kostoje të ndodhur, ndërsa më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Llogari të Arkëtueshme*

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen me koston e amortizuar pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për rënie të vlerës.

*Investimet te mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim jamë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të fiksuar, për të cilat Drejtimi ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse Kompania do të shiste një vlerë të rëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si te disponushme për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim njihen në datën e marreveshjes dhe maten me koston fillestare duke përfshirë të gjitha transaksionet me kosto për këtë aktiv. Më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi,nese ka. Kosto e amortizuar matet me metodën e normës efektive të interesit. Primi dhe vlerat e skontuara, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën e mbartur të instrumentit përkatës dhe amortizohen duke u bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, kur aplikohet.

**Detyrimet financiare**

Kompania i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime financiare.

A. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

B. Huamarrja

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqeria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

**Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare**

A. Aktivet e mbartura me koston e amortizuar

Kompania vlerëson në çdo datë të bilancit nëse ka evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet dhe humbjet e zhvlerësimit ndodhin vetëm nëse ka evidenca objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të

ktivit ( një 'ngjarje humbjeje') dhe që një ngjarje humbjeje (ose disa ngjarje) kanë ndikim mbi flukset monetare të parashikuara të aktivit dhe që mund të vlerësohet me efektivitet. Periudha përkatëse mes një humbjeje dhe identifikimit të saj përcaktohet nga drejtimi

Në përgjithësi, periudhat e perdorura variojnë nga tre në 12 muaj; në raste të veçante përdoren periudha më të gjata.
Nje provizion per renie vlere te Huave dhe Llogarive te arketushme krijohet atehere kur eshte evidente qe Kompania nuk do te jete ne gjendje qe t'i arketoj te gjitha shumat ashtu sic ishte parashikuar ne termat fillestare të Huave dhe të Llogarive të Arkëtueshme. Konsiderohen tregues te renies se Vleres se Huave dhe Llogarive te arketueshme:
Veshtiresi te rendesishme financiare te debitorit, ndoshta debitori ka hyre ne rrugen e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat ne pagesa. Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës së mbartur të aktivit dhe vleres aktuale te flukseve te parashikuara te ardhshme te parave, të skontuara me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivit zvogelohet duke perdorur nje llogari Zbritje te vleres, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ne zerin e shpenzimeve te shitjes dhe administrimitnë. Kur ndonje Hua ose Llogari e Arkëtueshme nuk mund te arketohet, ajo crregjistrohet ne debi te Llogarise Zbritje te vleres dhe ne kredi te llogarise te arketueshme. Nese me pas arketohet shuma te cilat jane crregjistruar , atehere kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit per keto shuma.

**Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare**

Në përputhje me SKK2 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin paranë (arkëtimet në para dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrrenspondojnë me Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

**Menaxhimi i Riskut**

*Manaxhimi riskut financiar*

Aktivetitet e Kompanisë janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe manaxhimin e disa shkallëve të riskut ose kombinime të risqeve. Marrja përsipër e riskut është thelbësore për bizneset financiare, dhe risqet operacionale janë pasoja të paevitueshme e të qënurit biznes. Prandaj, qëllimi i Kompanisë është të arrijë një balancë të përshtashme midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërta në performancën financiare të Kompanisë. Manaxhimi i riskut zbatohet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Finances. Ky department identifikon, vlerëson dhe mbrohet ndaj risqeve financiare në bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Kompanisë. Kompania zbaton parimet në lidhje me manaxhimin e riskut të përgjithshëm dhe politikat e shkruara që mbulojnë fusha të specifike, të tilla si risku nga kursi i këmbimit, risku i normave të intersit, risku i kreditimit, risku operacional etj.

Paraqitja e vertete dhe e drejte e pozicionit financiar ka ardhur si rezultat I nje regjistrimi te besueshem e te sakte te efekteve te transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve te tjera ne perputhje me perkufizimet dhe kriteret e njohjes se aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve te percaktuara ne SKK:

a) Perputhja e plote midis tepricave te llogarive ne mbyllje te vitit 2019 me ato ne celje te vitit 2020.
b) Per njohjen e te ardhurave dhe shpenzimeve

Te ardhurat dhe shpenzimet jane njohur sipas kontabilitetit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara. Sipas SKK-ve te ardhurat nga shitja e mallrave te produkteve apo sherbimeve jane njohur kur jane kaluar bleresit te gjitha rreziqet dhe perfitimet, maten me besueshmeri dhe prej tyre jane realizuar dhe marre perfitimet. Te ardhurat jane vleresuar me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, te shenuar ne faturat e shitjeve mbi bazen e cmimeve aktuale te tregut. Shpenzimet jane njohur me koston e blerjes se mallrave dhe sherbimeve sipas faturave te te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

# BILANCI KONTABEL

## AKTIVI

Ne zerin Aktive Monetare ( klasa e peste) pasqyrohet gjendja bankare e shoqerise sipas numrave te llogarise ne Raiffeisen bank ,Tirana Bank dhe OTP Bank ,Bkt,Nbg bank,Union bank deri me 31.12.2020 qe e vertetojne dhe ekstraktet e bankes.

**Ne fund te vitit 2020 gjendja bankare eshte 2,614,034 leke.**

***<u>Me poshte jepen te detajuara llogarite me celjet :</u>***

| | | 2020 | 2019 |
|---|---|---|---|
| | **AKTIVET AFATSHKURTRA** | **300,140,884** | **305,010,843** |
| **1** | ***Aktive monetare*** | | |
| 1.1 | ***Arka*** | | |
| | Arka e shoqërisë | 43 | **43** |
| | Leke | | |
| | Euro | | |
| | usd | | |
| | **Totali në Lekë** | **43** | **43** |
| 1.2 | *Banka* | | |
| | RAIFFEISEN LEKE | *2,347,985* | *40,747* |
| | BANKA POPULLORE | 12,891 | 65,561 |
| | TIRANA BANK | 1,159 | 1,159 |
| | THESARI | 99,688 | 9,431 |
| | BKT | 43,423 | 21,554 |
| | CREDINS BANK | 66,248 | 67,850 |
| | UNION BANK | 28,141 | 26,732 |
| | NGB BANK | 14,500 | 14,500 |
| | KURSI EURO | | |
| | KURSI DOLLARE | | |
| | **Totali në Lekë** | **2,614,034.62** | **247,533.89** |

Ne zerin Aktive te tjera financiare afatshkurtera pasqyrohet klasa e katert si llogaria e klientit ku teprica debitore ne fund te vitit 2020 eshte **160,420,859 leke e** cila pasqyrohet ne menyre analitike si me poshte :

**Debitoret e populates** jane ne <u>Shumen 137,001,174 leke</u>.
**Debitoret e lokaleve** private jane ne <u>Shumen 19,535,537 leke</u>
**Debitoret e enteve shteterore** jane ne <u>Shumen 2,601,388 leke</u>.

| | | | |
|---|---|---|---|
| | *Llogari te arketueshme* | *274,058,970* | *269,511,338* |
| | | | |
| 411 | KLIENTE CASH | 137,001,174 | 133,988,256 |
| 4111 | KLIENTE LOKAL | 19,535,537 | 18,266,704 |
| 4112 | KLIENTE PER PIKE LIDHJE | 746,443 | 404,304 |
| 41120 | KLIENTE PER MATESA | 239,760 | 93960 |
| 41121 | KLIENTE PER MATESA | 296,556 | 415,397 |
| 412 | KLIENTE ENTE | 2,601,388 | 2,705,276 |
| | Zhvlerësim klientë | | |
| | **Totali** | **160,420,859** | **155,873,897** |

Debitoret e falur sipas ligjit Nr.10418 date 21.04.2011 jane falur deri ne periudhen e kalimit ne varesi te pushtetit vendor 31.03.2008 ne shumen **55.357.818 leke** Edhe per vitin 2020 vazhdojne te jene po ne kete llogari 416 .Nga audititmi eshte lene qe te sistemohet llogaria e debitoreve te falur me debitoret actual, sipas nje process verbali te mbajtur nga dega shitjes mbi verifikimin e listave te debitoreve dhe perfaqesuesit te programit Al billing.Debitoret e falur jane **54.326.448** leke.Dhe llog 4161 jan klient te falur si diferenc cmimi nder vite ne shume **4,294,352 lek .**

**Total gjendje 113,637,441 lek**

## DEBITOR DHE KREDITOR TE TJERE .

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | *KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME* | | |
| 428 | DEBITORE NE PERSONA | 640,796.00 | 693,226.00 |
| 4632 | DEBITORE AFATGJATE | 448,202.00 | 448,202.00 |
| 467 | DEBITORE DHE KREDITORE TE TJERE | (14,052,161.40) | 35,614.05 |
| 4711 | POSTA KRUJE | 133,979.00 | 133,979.00 |
| 4713 | FITIM BALLA | 65,025.00 | 65,025.00 |
| 4714 | ALFRED CELA | 14,500.00 | 14,500.00 |
| 4715 | ENTELA MUHA | 20,541.00 | 20,541.00 |
| 4716 | MET CACA | 891,383.00 | 891,383.00 |
| | **Totali** | **-11,837,735** | **2,302,470** |

Ne llogarine kerkesa te tjera te arketueshme ne Shumen **negative 11,837,735 leke** e cila perfaqeson detyrimin per punonjesit keshillit mbikqyres per shoqerine ujesjellesit te fushe krujes te cilet jane perthithur gjate bashkimit dhe jane pjese e kontrollit te KLSH se lene para vitit 2016 **.Fitim Balla,Alfred Cela ,Entela Muha ,Met Caca,Posta Kruje ne total 1,125,428 lek** .Zeri ne llogarine 467 eshte me gjendje negative ne **Shumen 14,052,161 lek** (zeri qe ze peshen me te madhe te kerkesave te tjera te arketushme) nje detyrim sipas vendimit te gjykates se krujes nr 426 date 01.11.2018 per demshperblim te Kreditorit Z. Ermal Kasmi ,vendim I lene ne fuqi nga vendimi I apelit tirane nr 961 date 11.12.2019.Vendimi eshte ½ e e detyrimit total mbasi pjesa tjeter e shumes I eshte ngarkuar bashkise kruje me titull ekzekutiv te permbarueses Suela Hoxha .

Personeli dhe persona ne Shumen **640,796 leke** e cila perfaqeson vjedhjen e nje elektropompe ne Picrrage me vlere 150.000 leke, detyrimin e Aida Dedes dhene teper tatimi ne burim ne Shumen 1.454 leke.Llog debitore ne persona ne fund te vitit shtohet per **Shumen 558.123** leke nga inventari ekonomik per materialet ne ngarkim personave si Firma Incovest ne kohen kur ka punuar si firme konsulente me prijektin e fazes se dyte,material te cilat nuk e ka dorezuar ne Shumen 313.286 leke, Meleq Guni stacion baze per perdorimin radio marrse ne Shumen 244.837 leke.Ne lidhje me firmen incovest e kemi njoftuar disa here nepermjet emailit por nuk na eshte kthyer asnje pergjigje.Prandaj vendosem te bejme sistemimin e llog 218 ne llog

debitore ne persona sipas vendimit te keshillit mbikqyres .Kemi gjetur adresen e sakte dhe do ti bejme shkrese zyrtare .Ne Shumen **17,481 lek** jane diferense e librezave per vitet 2016-2018. Gjithashtu eshte kredituar shuma e pageses se sindikates ,shume e mbajtur per miratimin e vendimit per zbatim te VKM se pages ne natyre ne Shumen **21,300 lek** .Kreditohet shume e faturuar ne **Shumen 30,000 lek** per gjobat e vendosur te abonentave . Per elektropompen e vjedhur ka ardhur nje shkrese nga Prokuroria e Rrethit Kruje,pasi vepra penale eshte shuar ,por jo nga gjykata,prandaj vazhdon te jete ne llogarine debitore ne persona.

Ne zerin inventar klasa tre perfshihet vleresimin ne hyrje te inventareve e vila eshte bere me cmimet (kosto)e blerjes dhe gjendjen e magazinave e ujesjellesit deri me 31.12.2020 .Mbajtja e inventareve eshte me kosto te mesatare te ponderuar sipas programit Financa 5.E ndare ne zerat si material ndihmese hidraulike dhe johidraulike ,mallra ndihmese, kancelarike, klor, boje dhe mallrat e ndryshme . Inventari I imet deri me 31.12.2020 ne shumen **854,819 leke.**

Gjendja totale e llogarise lende e pare eshte **34,430,194.**

Ne zerin Aktive Afatgjata Materiale klasa dy perfshihen mjetet kryesore te shoqerise si toka ,ndertesa,ujesjellesa,kanalizime,makineri paisje,mjete transporti dhe inventar ekonomik.
Ne bilancin e vitit 2020 vlera e mjeteve kryesore paraqitet me vleften e mbetur ( vlera aktuale – vleren e amortizuar ).
Nje pjese e amortizimit nuk eshte llogaritur sepse eshte akumuluar plotesisht .

| Asetet | 31.12.2019 | SHTESA | PAKESIME | 31.12.2020 | 2020 | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzime te zhvillimit | 251,455.00 | 0.00 | 0.00 | 251,455.00 | 226,938 | 238, |
| Toka | 17,894,178.00 | 0.00 | 0.00 | 17,894,178.00 | 17,894,178 | 17,894, |
| ndertesa industriale | 79,509,726.00 | 0.00 | 0.00 | 79,509,726.00 | 45,429,294 | 47,937, |
| Kanalizime | 409,272,894.00 | 0.00 | 0.00 | 409,272,894.00 | 117,015,190 | 129,517, |
| Unjesjellesa | 732,631,664.00 | 0.00 | 0.00 | 732,631,664.00 | 537,763,445 | 560,144, |
| instalime teknike specifike | 28,364,249.49 | 740,000.00 | 134,828.00 | 28,969,421.49 | 9,292,722 | 12,001, |
